



REPUBLIKA E KOSOVES AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. _____ Dep. _____ Dep. _____ Nr. i faq. _____ Broj stranica _____ Nr. pages _____	Nr Prot. _____ Bi Prot. _____ Prot No. 03-02/159/A Data _____ Datum 25.01.2017 Date _____ P R I N T I N E



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.01.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-4692-16, për Zyrtarin e lartë z.Caslav Milosavleviç-Këshilltar në Zveçanit, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nën dyshimin për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. AKK-03-02-4692/16, për Zyrtarin e lartë, z.Çaslav Milosavleviç-Këshilltar Komunal në Zveçan, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznes privat, është trajtuar sipas procedurave të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit ka bërë shkresë njoftuese zyrtarit të lartë z.Çaslav Milosavleviç (DPK-03-02-4775-16), dhe pastaj ai ka kontaktuar Agjencinë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Milosavleviç është deklaruar se brenda afatit do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në biznes për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar ndryshimet në biznes (DPK/Dpki-03-02/141/17) të bëra në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilin shihet se, z.Milosavleviç tashmë ka hequr dorë nga e drejta e të qenurit person i autorizuar në biznes privat, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit


/ Shqip Havolli /






REPUBLIKA E KOSOVËS AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br Prot. Prot No.
Nr. lfaq Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
PRISTINE	

DPK 1

03-02/159/17

25.01.2017



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

U skladu sa članom 11 (stav 1.1), članom 5 (stav 1, tačka 1.5), članom 18 (stav 10 i 11) Zakona br. 03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije, kao i sa članom 19 (stav 11) Pravilnika br. 01/2014 o Radu Agencije protiv Korupcije, Direktor Agencije protiv Korupcije, dana 23.10.2017 doneo je:

ODLUKU

I. Zatvara se slučaj br. AKK-03-02-4692-16, za Visokog Zvaničnika g. Časlava Milosavljevića – Savetnik u Opštini Zvečan, za što je izbegnuta situacija sukoba interesa u vršenju javne funkcije.

II. Slučaj se može obnoviti u svako doba ukoliko se pojavljuju nove okolnosti.

O b r a z l o ž e n j e

I. Slučaj je otvoren pod osnovanom sumnjom o Sukobu interesa u toku vršenja javne funkcije, pod sumnjom o Sukobu interesa u toku vršenja javne funkcije, br. AKK-03-02-4692/16 za Visokog Zvaničnika, g. Časlava Milosavljevića – Savetnik Opštine, i istovremeno ovlašćeno lice u privatnom biznesu, tretiran je prema predviđenoj proceduri Zakona za Sprečavanje sukoba interesa u toku vršenja javne funkcije.

Agencija protiv Korupcije je prvo, službenim pismom upoznala visokog zvaničnika g. Časlava Milosavljevića (DPK-03-02-4775-16), i posle toga on je kontaktirao Agenciju protiv Korupcije, s' kojim slučajem je upoznat sa situacijom u kojoj se nalazio, kao i sa izmenama koje treba izvršiti da bi izbegnuo situaciju sukoba interesa u vršenju svoje javne funkcije.

Visoki zvaničnik, g. Milosavljević je izjavio da će u roku izvršiti potrebne izmene u biznisu, da bi izbegao situaciju sukoba interesa u vršenju svoje javne funkcije.